

MIKUⁱ VULLNETARIT

Referendumi për Shfuqizimin e Ligjit Nr.21/2024

Volunteer
Playbook



ME MBESHTETJEN E



AlbNatyra

Organizatë mjedisore me përvojë në mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe përfshirjen e komuniteteve.

Lumi

LUMI – Lëvizja për Ujërat, Mjedisin dhe Integrimin

Organizatë mjedisore që punon për mbrojtjen e natyrës dhe ujërave, biodiversitetin dhe fuqizimin e komuniteteve.



RESU – Reinforce Sustainability

Organizatë e drejtuar nga të rinjtë, me fokus te qëndrueshmëria, natyra, kërkimi, edukimi dhe fuqizimi i komuniteteve.



Revolucioni Flamingo

Lëvizje qytetare që ka mobilizuar zëra brenda dhe jashtë Shqipërisë për mbrojtjen e zonave të mbrojtura, transparencën dhe interesin publik.

Kjo nismë është forcuar nga organizata, rrjete dhe komunitete që kanë kontribuar përmes ekspertizës, bashkëpunimit, angazhimit në terren, komunikimit dhe mbështetjes publike. U jemi mirënjohës për besimin, kohën dhe kontributin e tyre në forcimin e këtij procesi qytetar dhe mbrojtjen e interesit publik.

PËRMBAJTJA *Contents*

Ky udhëzues është ndarë në shtatë pjesë. Nuk pritet ta lexosh tërësisht përpara turnit të parë — kapitujt 1–5 mjaftojnë për të filluar; pjesa tjetër është atje kur të duhet.

I • PSE JEMI KËTU

- 1 Mirë se vini
 - 2 Kush jemi
 - 3 Misioni ynë & Betimi
-

II • SFIDA

- 4 Matematika e lëvizjes
-

III • KUSH JENI JU

- 5 Profili i vullnetarit
 - 6 Parimet tona
-

IV • SI FUNKSIONON

- 7 Struktura dhe rolet
 - 8 Mbështetje dhe udhëzime
 - 9 Mbledhja e firmave
 - 10 Çanta jote e punës
 - 11 Skenarë të mundshëm
 - 12 Portali i vullnetarit
-

V • ANGAZHOTHU

- 13 Bëhu edhe aktivist
-

VI • KUJDESI PËR TY


- 14 Siguria dhe mbrojtja jote
 - 15 Pyetje të shpeshta
-

VII • PRITSHMËRI DHE VLERËSIM

- 16 Çfarë presim nganjëri-tjetri
 - 17 Të arriturat e tua
-

SHTOJCAT

- A Pse duhet referendum
 - B Bëj / Mos bëj
 - C Politikat e plota & Fjalorth
 - D Burimet
-



1 MIRË SE VINI

MIRË SE ERDHE NË KËTË UDHËTIM.

Diçka u zgjua në Shqipëri këtë verë. Qytetarë të zakonshëm, të lodhur nga heshtja dhe padrejtësia, dolën në rrugë kur panë si zonat tona të mbrojtura po binin për ndërtimit — me një ligj për të cilin askush nuk na pyeti.

Lëvizja që lindi prej kësaj mori emrin **"Revolucioni i Flamingove"**, sipas shpendëve që jetojnë në ligatinat sot nën kërcënim.

Sot, ai vrull po shndërrohet në diçka konkrete: një referendum apartiak kombëtar — i pari i këtij lloji që prej vitit 1998 — ku qytetarët, jo politikanët, do të vendosin nëse **Ligji Nr. 21/2024** duhet shfuqizuar.

2 NISMA MBETET QYTETARËVE

tani je pjesë e saj je edhe ti.

KUSH JEMI



12 qytetarë që e paraqitën zyrtarisht kërkesën pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe që mbajnë përgjegjësinë ligjore për procesin. Ata janë aplikuesi zyrtar — asnjë parti politike.



Rrjeti i shqiptarëve të diasporës që mbështet nismën me studime, informim publik, edukim qytetar dhe koordinim praktik. Nuk e drejtojmë nismën dhe nuk zëvendësojmë KQZ-në apo çdo institucion tjetër.



TAKONI NISMETARET

Këta janë 12 qytetarët nismëtarë që kanë marrë përsipër përgjegjësinë formale për nisjen e referendumit për Ligjin nr. 21/2024. Vijnë nga profesione, eksperiencë dhe angazhime të ndryshme, por i bashkon një bindje e përbashkët: që qytetarët duhet të kenë mundësinë ta ushtrojnë drejtpërdrejt të drejtën e tyre kushtetuese për të vendosur.



Besjana Guri

Aktiviste mjedisore, fituese e Goldman Environmental Prize 2025 dhe drejtoreshë ekzekutive e LUMI



Blendi Salaj

Gazetar, moderator, pedagog dhe aktivist social



Ersid Domnori

Dentist dhe studiues në shkencat dentare



Gentiana Kapllani

Juriste me fokus në teknologjinë ligjore dhe transparencën



Gëzim Shuli

Aktivist mjedisor dhe Drejtor Ekzekutiv i AlbNatyra



Irimi Myftaraj

Studente e gazetarisë dhe aktiviste qytetare



Joniada Ngjelo

Profesioniste e IT-së, me përvojë në ligj, dhe aktiviste qytetare



Lazjon Petri

Biolog mjedisor, autor, përkthyes dhe profesionist i ruajtjes së natyrës



Mateo Yskollari

Aktivist dhe analist i politikave arsimore



Migena Kukli

Inxhinierë dhe eksperte mjedisi



Oljam Dërvishi

Inxhinier mjedisi, kërkues dhe drejtues i RESU



Rikaldo Çelaj

Arkeolog me përvojë në turizëm dhe trashëgimi kulturore

3 MISIONI YNË

Misioni ynë është i thjeshtë: t'i kthejmë shqiptarëve autoritetin mbi tokën, ujin dhe natyrën e vendit të tyre.

Ligji Nr. 21/2024 hoqi kufizimet mbi ndërtimin brenda zonave tona të mbrojtura dhe ia besoi vendimin një zinxhiri institucionesh që, në fund të fundit, drejtohen nga të njejtët persona, qellimet dhe ambiciet e të cilëve nuk janë të njëjta me ato të popullit Shqiptar.

Bashkimi Evropian e ka kërkuar zyrtarisht shfuqizimin e tij — dy herë, në dy rezoluta radhazi të Parlamentit Evropian — si kusht për mbylljen e Kapitullit 27 të negociatave. Qeveria është përgjigjur se do ta “përshtasë”, jo ta shfuqizojë.

Kur çdo derë tjetër institucionale rezulton e mbyllur, Kushtetuta ka lënë hapur vetëm një: **Neni 150**. Referendumi nuk është protestë dhe as peticion — është instrumenti kushtetues përmes të cilit populli, **dhe vetëm populli**, vendos drejtpërdrejt.

*Mëso më shumë: Shtojca A, “Pse duhet referendum”, dhe **faqja “Kupto” e faqes sonë të internetit.***



DEKLARATA VULLNETARIT

Kjo është nisma jote tani. Parase të dalësh në terren, të kërkojmë të lexosh dhe të nënshkruash si premtim që e mban veten dhe nismën të pastër.

BETIMI I VULLNETARIT

Unë, i nënshkruari/a, pranoj të marr pjesë në këtë nismë qytetare si vullnetar/e, dhe zotohem:

Të mbetem jo-partiak dhe të mos e përdor këtë nismë për të promovuar parti, kandidat apo interes personal;

Të veproj me ndershmëri dhe respekt ndaj çdo qytetari që takoj;

Të mbroj privatësinë dhe të dhënat personale të çdo nënshkruesi;

Të ndjek udhëzimet ligjore dhe të sigurisë të përcaktuara nga grupi nismëtar dhe kordinatorët;

Të përfaqësoj këtë nismë me dinjitet, edhe kur takoj kundërshtim.

Emri: _____

Nënshkrimi: _____

Data: _____



4 RRUGA DREJT 50,000+

Numrat e fitores, dhe arsyeja pse çdo turn, çdo bisedë, çdo firmë e ka rëndësi.

Pragu kushtetues

Neni 150 i Kushtetutës kërkon 50,000 nënshkrime të vlefshme nga shtetas me të drejtë vote.

Në praktikë, një pjesë e nënshkrimeve — zakonisht 20–30% — skualifikohet gjatë verifikimit zyrtar, për shkak të shkrimit të palexueshëm ose gabimeve në të dhënat e regjistrimit. Prandaj synojmë ndjeshëm më shumë se pragu minimal prej 50,000 firmash.

PJESA III • KUSH JENI JU

5 PROFILI I VULLNETARIT

Nuk ka vetëm një lloj të vullnetari. Kjo fushatë ka nevojë për njerëz të llojeve krejt të ndryshme, në vende krejt të ndryshme — dhe secili prej tyre ka vendin e tij/saj.

FLAMINGO TERREN

Flet me qytetarët, ndihmon mbledhësin, mban rendin te tavolina. Nuk kërkohet përvojë apo e drejtë vote; kërkohet durim dhe respekt.

MBLEDHËS AUTORIZUAR

Duhet të jetë shtetas shqiptar me të drejtë vote dhe të ketë autorizim me shkrim nga grupi nismëtar. Mban përgjegjësinë për fletët dhe raporton numrat.

KOORDINATOR

Drejton 2–3 njësi terreni: planifikon turnet, zgjidh probleme të vogla në terren, mban lidhjen me qendrën. Ky rol kërkon disponueshmëri aktive

QENDRA


(jurist, logjistikë, IT, PR, Burime njerëzore)

Ekspertizë specifike, jo doemos në Shqipëri. Punë nga distanca, e mundshme edhe nga diaspora. Ndhmon me informim, përkthim, organizim ambientesh dhe ngjarjesh brenda dhe jashtë Shqipërisë.

NUK JE I/E SIGURT CILI ROL TË PËRSHTATET?

REGJISTROHU NË PORTAL — EKIPI I KOORDINIMIT DO TË TË KONTAKTOJË PËR ROLIN MË TË PËRSHTATSHËM.

REGJISTROHU



PËR TË REFERENDUAR



6 PARIMET TONA

Rregullat e Flamingove

Jemi një lëvizje qytetare, jo një parti, dhe jo një zyrë. Këto parime na mbajnë të besueshëm — për qytetarët që firmosin dhe punojnë me ne, dhe për njëri-tjetrin.



Interesi publik: punojmë për pjesëmarrjen qytetare dhe angazhim të bazuar në fakte.



Respekt: trajto njerëzit me dinjitet. Sfidu idetë, jo individët.



Integritet: fol saktë, dëgjo, prano gabimet, korrigjo hapur.



Pavarësi: mos e përdor këtë nismë për parti politike, fushatë apo interesa personale.



Dëshmi: ndaj qartë faktin nga mendimi dhe nga pasiguria.



Bashkëpunim: ndaj informacion, ndihmo të tjerët, vlerëso kontributin e tyre dhe tëndin.



Konfidencialitet: mbro bisedat e brendshme dhe të dhënat personale.

Ç'NUK PRANOHET

Ngacmime, sulme personale, dezinformim i qëllimshëm, përfaqësim i paautorizuar i UDACN-së ose nismës, keqpërdorim i informacionit konfidencial.

Shiko Kapitullin 14, “Siguria dhe mbrojtja jote” dhe Kapitullin 15 “Kodi i Sjelljes dhe Angazhimit”



Lexo Shtojcën C dhe skano për të vizituar ‘Parimet dhe Standardet’ tona në faqen tonë zyrtare.



STRUKTURA DHE ROLET

Nisma është ndarë në tri shtresa. Kjo ndarje nuk është hirearkike — është strategji pune dhe përgjegjësie.

Juristët

Marrëdhënie me admin, prokura, vendime ligjore.

E pavarur nga zinxhiri i komandës

SHTRESA 1 · QENDRA

Vendimmarrje e centralizuar për objektivat afatgjata dhe ruajtjen e integritetit strukturor.

Admin

Komunikim me ekipin ligjor, mban strukturën dhe koordinimin.

Platforma IT

Aplikacioni i raportimit, numërimi i nënshkrimeve, faqja e internetit.

Përmbajtja

Rrjete sociale, PR, marketing, materiale edukative.

Logjistika

Printim formularësh, përgatitje setesh, ruajtja e dokumenteve.

Rekrutimi

Rekruton njerëz të rinj, ndan burimet njerëzore të njësitë.

SHTRESA 2 · KOORDINATORËT

~1 për 2-3 njësi. Trajtojnë çështjet e njërive, koordinojnë orarin. NUK drejtojnë punën e përditshme.

Koordinator

Rajoni A - grup njësisish

Koordinator

Rajoni B - grup njësisish

Koordinator

Diaspora - transport / ligj lokal

SHTRESA 3 · NJËSITË NË TERREN

Çdo njësi = 1 mbledhës i autorizuar + 4-5 ndihmës. Territor, objektiv dhe kuti e vet. Kopjohet shumë herë.

Njësia A1

Zona 1

Njësia A2

Zona 2

Njësia B1

Zona 3

Njësia B2

Zona 4

Diaspora C1

Qyteti X

... x N njësi të tjera

Brenda çdo njësie ("njësia-në-kuti"):

- Mbulesa e vet ligjore (mbledhës i autorizuar/prokurë)
- Territor i përcaktuar, pa mbivendosje me njësi tjetër
- Objektiv i qartë (p.sh. sa firma në javë)
- Set: formularë, mbajtëse, ID, fletushka, printer, QR
- Manuale: guide-book, fletë-palosje, pyetjet e shpeshta
- Raportim te aplikacioni IT (numri i firmave)
- Protokoll për dokumentet dhe privatësinë
- Rekrutim ndihmësish, nëpërmjet grupit të Rekrutimit

Vendos vetë: ku/kur të mbledhë, kush janë ndihmësit, taktikat lokale, orari.

Përshkallëzon: vetëm çka është e re ose e paprovuar → koordinatori → admin → juristët.

Autonomia në terren mundësohet nga standardizimi i strukturës.

SHËNIM:



Ekipi ligjor qëndron veçmas, si trupë këshillimore e pavarur — jo pjesë e zinxhirit të komandës së terrenit; miraton formularin, harton udhëzimet ligjore dhe trajton çdo "Shqetësim ligjor", por nuk sheh të dhëna personale të vullnetarëve dhe nuk cakton role apo njësi.

7 STRUKTURA DHE ROLET

Nisma funksionon si një ekip i vetëm, por secili ka një rol të qartë. Ekipet në terren punojnë drejtpërdrejt me qytetarët; koordinatorët organizojnë njerëzit dhe turnet; ndërsa ekipet mbështetëse kujdesen për materialet, njerëzit, komunikimin, teknologjinë dhe procesin ligjor.

Këto janë disa nga rolet dhe nën-ekipet me të cilët mund të angazhohesh:

FLAMINGO TERREN^{ne}

Flasin me qytetarët, ndihmojnë në organizimin e pikës dhe mbështesin marrjen e firmave.



MBLEDHËS AUTORIZUAR


Mban përgjegjësinë për mbledhjen e nënshkrimeve në njësinë e vet, kujdeset për formularët dhe raportimin e saktë të turnit. Drejton ekipin e vogël në terren.

KOORDINATOR

Mban të organizuara 2–3 njësi dhe kujdeset për njerëzit, turnet, materialet dhe çështjet që lindin në terren. Është lidhja kryesore mes ekipeve në terren dhe Qendrës.

BRESHKAT LOGJISTIKË^e

Kujdesen që çdo ekip të ketë në kohë formularët, kartat dhe materialet që i duhen. Organizojnë shpërndarjen dhe transportin, mbajnë evidencën e formularëve dhe sigurojnë dorëzimin e tyre të rregullt dhe të sigurt.



Kujdesen për njerëzit që e bëjnë të mundur nismën. Mirëpresin dhe orientojnë vullnetarët e rinj, ndihmojnë me trajnimet, ndjekin nevojat e ekipeve dhe sigurohen që askush të mos mbetet pa mbështetje.

PELIKANËT BURIMEVE NJERËZORE



Kujdesen që zëri i nismës të jetë i qartë, i saktë dhe i njëjtë kudo. Përgatisin materialet, menaxhojnë komunikimin dhe rrjetet sociale, punojnë me median dhe ndihmojnë në korrigjimin e dezinformimit dhe sqarimin e pyetjeve publike.

DALLËNDYSHET KOMUNIKIMIT & EDUKIMIT

PULËBARDHAT TEKNOLOGJISË^e

Mbajnë në funksion pjesën digjitale të nismës: portalin, kartat, sistemet, kopjet rezervë dhe sigurinë e të dhënave. Nëse nuk hyn dot në portal, diçka nuk funksionon ose ke një problem teknik, ky është ekipi që të ndihmon.



Flamingot e Terrenit · Mbledhësit e autorizuar · Koordinatorët



Breshkat · Logjistikë



Pelikanët · Vullnetarët & Mirëqenia



Dallëndyshet · Komunikim & Edukim



Pulëbardhat · Teknologji & IT



Ekipi Ligjor



Qendra · Administrim & Koordinim

Përshkrimi i plotë i secilit rol ndodhet në dokumentin I plotë "BIBLA", të disponueshëm në portal.

8 EKIPI ËSHTË PRANË JUSH

Ne nuk punojmë vetëm dhe nuk e “menaxhojmë” njëri-tjetrin - punojmë në ekip, dhe çdo ekip ka mbështetjen që i duhet.

KUJT T'I DREJTOHESH

Pyetje për orarin, vendndodhjen ose materialet e turnit

MBLEDHËSI I AUTORIZUAR
NËNSHKRIMEVE

Çështje me ekipin ose mungesë materiale

KOORDINATORI I EKIT

Pyetje ligjore ose paqartësi me formularët

EKIPI LIGJOR

Situata personale, tensione dhe mirëqenia jote

EKIPI I BURIMEVE NJERËZORE

Media, informacion i pasaktë ose dezinformim

EKIPI I KOMUNIKIMIT
DHE EDUKIMIT

Çështje që mbeten të pazgjidhura për më shumë se 48 orë

ADMINËT E QENDRËS

NË RAST TË RREZIKUT TË MENJËHERSHËM

Nëse ka rrezik të menjëhershëm, telefononi menjëherë personin përgjegjës ose shërbimet përkatëse — mos prisni të raportoni në portal. Siguria juaj dhe e ekipit vjen gjithmonë e para. Raportimi në portal bëhet vetëm pasi situata të jetë qetësuar dhe siguria të jetë garantuar.

TRAJNIMI DHE TAKIMET

Ekipi qendror organizon takime orientuese për çdo vullnetar të ri, si edhe takime të rregullta për koordinatorët. Pjesëmarrja në trajnimin hyrës është e nevojshme përpara turnit të parë, për t'u siguruar që çdo vullnetar/e ndihet i/e përgatitur, i/e qartë dhe i sigurt në komunikimin me qytetarët. Në terren, shpesh ke vetëm pak sekonda për të shpjeguar nismën qartë dhe saktë — ndaj përgatitja paraprake ka shumë rëndësi.



SI MBLIDHET NJË FIRMË

Kjo pjesë shpjegon procesin bazë të mbledhjes së një firme, nga paraqitja e qytetarit deri te ruajtja dhe dorëzimi i formularit.



Kjo është skema zyrtare, e njëjtë me atë të publikuar te **“Përfshihuni”** në faqen tonë. Mëso e nihe mirë — do të jetë biseda jote e parë me çdo qytetar.

KUSH MUND TË FIRMOSË

Mund të nënshkruajnë shtetasit shqiptarë me të drejtë vote, të regjistruar si zgjedhës.

Qytetari duhet të paraqitet personalisht me pasaportë ose kartë identiteti vlefshme.

Të dhënat identifikuese të kërkuara në formular, përfshirë numrin personal, duhet të plotësohen saktë në mënyrë që nënshkrimi të mund të verifikohet.

1

Kontrollo statusin: Përpara se të nisesht, kontrollo gjithmonë “Ndiq/Track” portalin e vullnetarëve për siguruar që informacioni mbi fazën e procesit, pikat aktive dhe udhëzimet është i përditësuar.

2

Paraqitu: Qytetari paraqitet vetë në pikën e autorizuar, me letërnjoftim ose pasaportë të vlefshme. Askush nuk mund të nënshkruajë në emër të një familjari, miku apo personi tjetër.

3

Verifiko njësinë dhe mbledhësin e autorizuar: Qytetari ka të drejtë të sigurohet që ndodhet në një pikë të autorizuar dhe që personi që po mbledh firmat është i autorizuar për ta bërë këtë. Nëse kërkohet, paraqit autorizimin me shkrim.

4

Lexo përpara se të nënshkruash: Përpara nënshkrimit, qytetari duhet të ketë mundësi të lexojë:

- kërkesën për të cilën po jep nënshkrimin;
- informacionin përkatës në formularin e miratuar nga KQZ;
- informacionin mbi përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.


Nëse qytetari ka pyetje, shpjego procesin qartë dhe pa ushtruar presion.

5

Firmos vetëm një herë: Qytetari nënshkruan vetëm një herë dhe, përpara se të largohet, kontrolloni që të dhënat e tij të jenë shënuar saktë dhe qartë.



SKANO



PËR TË REFERENDUAR

SI BËHESH MBLEDHËS I AUTORIZUAR

Për të mbledhur nënshkrime në emër të nismës duhet të përfundohen këto hapa:

- 1 Regjistro interesin tënd** për t'u angazhuar si mbledhës.
- 2 Përfundon procesin e verifikimit** të kërkuar nga grupi nismëtar, përfshirë kushtet që lidhen me të drejtën e votës dhe përshtatshmërinë për rolin.
- 3 Përfundon trajnimin mbi rolin e mbledhësit mbi:** trajtimin e formularëve, privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave, aksesueshmërinë dhe sjelljen në terren.
- 4 Merr autorizimin me shkrim. Nënshkrimet mbledhen vetëm pasi autorizimi të jetë konfirmuar.** Regjistrimi si vullnetar, në vetvete, nuk të autorizon për mbledhjen e nënshkrimeve.

RUAJTJA DHE DORËZIMI I FORMULARËVE

Çdo formular i nënshkruar është dokument zyrtar dhe duhet trajtuar me kujdes të veçantë.

Në fund të çdo turni:

- **formularët numërohen dhe kontrollohen nga personi përgjegjës;**
- **mbahen gjatë gjithë kohës nën mbikëqyrje;**
- **dorëzohen sipas procedurës së përcaktuar dhe zinxhirit të kujdestarisë;**
- **çdo dorëzim regjistrohet sipas procedurës së ekipit.**



Formularët e plotësuar nuk fotografohen, nuk ngarkohen online, nuk shpërndahen në grupe komunikimi dhe nuk merren në shtëpi nga vullnetarët.

Nëse një formular humbet, dëmtohet, fotografohet pa autorizim ose dyshohet se është komprometuar, njofto menjëherë koordinatorin dhe ekipin përgjegjës

MBAJ MEND:



Kur nuk je i sigurt për një hap, mos hamendëso dhe mos e interpreto vetë procedurën. Pyet koordinatorin ose ekipin përkatës dhe vazhdo vetëm pasi të kesh marrë sqarimin e nevojshëm.



10 ÇANTA JOTE E PUNËS

Çfarë i duhet një vullnetari?



ÇFARË TË DUHET PËR TURNIN?

Përpara çdo turni, sigurohu që ke me vete gjithçka që të nevojitet dhe që materialet e pikës janë të plota. Formularët zyrtarë dhe materialet e identifikimit nuk improvizohen dhe nuk zëvendësohen me kopje personale.

NËSE TË DUHET MBËSHTETJE

Nëse të nevojitet mbështetje praktike gjatë angazhimit — për shembull për transportin, internetin celular, materiale apo shpenzime të tjera të arsyeshme që lidhen me turnin — na kontakto dhe e diskutojmë së bashku. Të gjithë po kontribuojmë pro bono, dhe synimi ynë është që askush të mos mbetet pas për arsye praktike apo financiare.

ÇFARË SIGURON NJËSIA JOTE

- Formularët zyrtarë të miratuar nga KQZ, në sasinë e përcaktuar për turnin.
- Kartën e identifikimit të vullnetarit, me fotografi dhe kodin QR për verifikim. *Kartat e identifikimit gjenerohen dhe printohen nga portali, pas miratimit të llogarisë - Shiko Kapitullin 12.*
- Fletëpalosjet informuese dhe Pyetjet Kryesore për terrenin, për t'iu përgjigjur pyetjeve më të zakonshme qartë dhe njëtrajtshëm.
- Materialet bazë të punës: stilolapsa, clipboard, dosje dhe çdo material tjetër i nevojshëm për administrimin e formularëve.
- Tavinë dhe çadër, kur pika dhe kushtet e terrenit e kërkojnë.



ÇFARË SJELL VETË

- Letërnjoftimin ose dokumentin tënd të identifikimit. Mbaje me vete gjatë gjithë turnit.
- Telefonin të karikuar, me akses në portal dhe me njoftimet përkatëse aktive.
- Ujë, veçanërisht gjatë ditëve të ngrohta.
- Veshje dhe këpucë të rehatshme, të përshtatshme për motin. Turnet zgjasin rreth dy orë (ose më shumë nëse keni dëshirë) dhe një pjesë e mirë e kohës mund të kalohet në këmbë.



11

‘PO SIKUR?’ - SKENARË TË MUNDSHËM

Dyzet sekonda me një kalimtar të nxituar ose një protestues akoma të painformuar nuk lënë shumë kohë për improvizim. Këto janë disa nga situatat që ne kemi hasur nga eksperiencat tona ose mendojmë që mund ti hasim — dhe si t'u përgjigjesh, thjesht dhe saktë.



"NUK JAM ENDE E VENDOSUR NËSE DUA SHFUQIZIMIN."

Mund të nënshkruash edhe nëse nuk e ke vendosur ende se si do të votoje në referendum. Nënshkrimi në këtë fazë mbështet vijimin e procedurës referendare; vota përfundimtare është një vendim i veçantë që merret më vonë.



"A MUND TË NËNSHKRUAJË DIKUSH NGA DIASPORA?"

Po, nëse është shtetas shqiptar me të drejtë vote dhe plotëson kushtet e kërkuara për nënshkrimin. Nënshkrimi bëhet personalisht, me kartë identifikimi ose pasaportë të vlefshme, në një pikë të konfirmuar të mbledhjes së nënshkrimeve.



"KUSH QËNDRON PAS KËSAJ NISME? ËSHTË E LIDHUR ME NDONJË PARTI?"

Jo. Kjo është një nismë qytetare, e pavarur dhe jopartiake. Grupi formal nismëtar përbëhet nga 12 qytetarë. UDACN (diaspora) dhe ne e mbështesim nismën përmes informimit publik, kërkimit, komunikimit dhe koordinimit.



MEDIA KËRKON NJË DEKLARATË OSE INTERVISTË

Mirëprite me respekt dhe ndihmoje të lidhet me personin e duhur. Trajnimi i vullnetarëve përfshin edhe drejtimin mediatik dhe ne jemi këtu për t'ju mbështetur.



DIKUSH BËHET AGRESIV, KËRCËNUES OSE USHTRON PRESION

Mos u përfshi në debat dhe mos e përshkallëzo situatën. Ruaj qetësinë, tërhiq së bashku me ekipin dhe njofto menjëherë koordinatorin.

Shiko edhe Kapitullin 14 për procedurën e plotë.



Për pyetje të tjera: Shtojca A dhe Kapitulli 15 (Pyetje të Shpeshta), ose FAQ e plotë e disponueshme në portal.

12

PORTALI I VULLNETARIT

Portali është vendi ku gjithçka bëhet zyrtare: regjistrimi, turnet, raportimi, karta jote, materiale, udhëzues, dhe video trajnuese.


ÇFARË DO TË GJESH ATJE?



**APLIKO DHE
REGJISTROHU**




**CHECK-IN PËR
TURNET E TUA DHE
VENDNDODHJA E
FLAMINGOVE TË TJERË**



KARTA JOTE



**TRAJNIME, UDHËZIME
DHE FORMËN E
RAPORTIMEVE TË
PROBLEMEVE**



Çdo vullnetar do të trajnohet për përdorimin e platformës dhe funksionet që lidhen me rolin e tij/saj. Nëse ke nevojë për ndihmë individuale ose dëshiron që dikush ta tregojë platformën hap pas hapi, mjafton të na kërkosh — jemi këtu për të ndihmuar.

13

BËHU EDHE AKTIVIST

Jo çdo kontribut kërkon një turn dyorësh në këmbë. Kjo nismë ndërtohet edhe nga shumë veprime të vogla, shpesh të padukshme, që së bashku bëjnë diferencën.

ME ÇFARË MUND TË NDIHMOSH:




EKSPLORO QENDRËN E REFERENDUMIT

Ky **mik** të jep informacionin kryesor që të duhet për punën në terren. Për shpjegime më të plota, dokumente, përditësime dhe informacionin më të fundit mbi procesin, drejtohu gjithmonë te qendra online e referendunit.

Edhe qytetarët mund t'i drejtosh aty sa herë që duan të lexojnë më shumë, të kontrollojnë një informacion ose të kuptojnë se çfarë ndodh më tej.

- **KUPTONI** Për të kuptuar çfarë është referendumi dhe pse po zhvillohet.
- **NDIQNI** Për të parë ku ndodhet procesi tani.
- **PËRFSHIHUNI** Për të parë si mund të marrësh pjesë.
- **VERIFIKONI** Për të kontrolluar informacionin përpara se ta besosh ose ta shpërndash.



VIZITO QENDRËN E
REFERENDUMIT



14

SIGURIA DHE MBROJTJA JOTE

Kjo është një nismë qytetare, paqësore dhe ligjore. Shumica dërmuese e kontakteve me qytetarët do të jenë të qeta dhe pozitive. Megjithatë, puna në hapësira publike mund të sjellë herë pas here tension, presion, keqinterpretim apo sjellje të papërshtatshme. Në asnjë prej këtyre situatave nuk pritet t'ia dalësh vetëm. Siguria, dinjiteti dhe mirëqenia jote kanë përparësi ndaj çdo turni, detyre apo objekti.

NË RAST RREZIKU TË MENJËHERSHËM:

Nëse ti ose dikush pranë teje ndodhet në rrezik të menjëhershëm fizik, telefono së pari shërbimet e urgjencës dhe largohu nga situata e rrezikshme. Njoftimi i koordinatori dhe raportimi përmes platformës bëhen më pas, vetëm pasi të jesh i sigurt.

NGACMIM, KEQPËRDORIM I IDENTITETIT OSE PUBLIKIM I TË DHËNAVE PERSONALE

Nëse dikush të ngacmon, pretendon në mënyrë të rreme se përfaqëson nismën, përdor identitetin tënd apo të ekipit pa autorizim, ose publikon të dhëna personale për ty pa pëlqimin tënd, mos u përfshi në përplasje personale dhe mos u përpqi ta zgjidhësh situatën vetëm.

Ruaj provat: bëj fotografi të ekranit, ruaj username-t, mesazhet, datën dhe çdo informacion tjetër të dobishëm dhe mos fshi asgjë që mund të nevojitet më vonë. Njofto menjëherë koordinatori dhe paraqite rastin përmes formularit **“Raporto një shqetësim”** në platformë.

OFENDIME, DENIGRIM OSE DISKRIMINIM

Nuk përgjigjemi me të njëjtën gjuhë dhe nuk lejojmë që një provokim të na tërheqë në një konflikt publik. Nëse dikush të ofendon, të nënçmon, të diskriminon apo përpiket të të provokojë, ruaj qetësinë, ndërprit bisedën nëse është e nevojshme dhe largohu nga situata. **Raportoje sa më shpejt!**

Përgjigjja jonë e parë është gjithmonë dinjiteti, jo replika.

KUJDESU PËR VETEN

Nëse një situatë apo bisedë të ka shqetësuar, tronditur ose lodhur emocionalisht, merr hapësirën që të nevojitet. Mund të largohesh për pak nga pika ose ta ndërpresësh turnin nëse nuk ndihesh mirë. Askush nuk duhet të ndihet i detyruar të vazhdojë vetëm për të përmbushur një turn. Fol me koordinatori ose me Ekipin e Burimeve Njerëzore.

Mirëqenia jote vjen përpara çdo objekti të mbledhjes së nënshkrimeve.

MOSMARRËVESHJE BRENDË EKIPI

Në çdo ekip mund të ketë mosmarrëveshje. Fillimisht përpikuni t'i zgjidhni me qetësi dhe respekt; nëse nevojitet, përfshihet koordinatori ose Ekipi i Burimeve Njerëzore. Rastet serioze ose të përsëritura shqyrtohen nga ekipi përgjegjës dhe mund të çojnë në kufizimin ose përfundimin e rolit në nismë.



SIGURIA DHE MBROJTJA JOTE



TË DHËNAT DHE PRIVATËSIA

Të njëjtin kujdes që tregojmë për të dhënat e nënshkruesve e zbatojmë edhe për të dhënat e vullnetarëve. Mblidhen vetëm të dhënat që janë të nevojshme për angazhimin tënd, ruhen në mënyrë të sigurt dhe përdoren vetëm për qëllimet e kësaj nisme.



Të dhënat e tua nuk shiten, nuk përdoren për fushata apo qëllime të tjera dhe nuk u kalohen palëve të treta pa një bazë të ligjshme ose pa pëlqimin tënd, kur ai kërkohet. Ato ruhen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme dhe fshihen në përputhje me afatet e përcaktuara në politikën tonë të privatësisë.

Lexo Shtojcën C dhe skano për të vizituar ‘Parimet dhe Standardet’ tona në faqen tonë zyrtare.

RREGULLA TË THJESHTA PËR SIGURINË NË TERREN

- **Mos puno vetëm:** Në terren puno gjithmonë me ekipin, sidomos në mbrëmje ose në pika të ngarkuara.
- **Njofto kur mbërrin dhe kur largohesh:** Koordinatori duhet të dijë kush është në turn dhe kur largohet.
- **Mos u përfshi në konflikt:** Nëse dikush provokon, refuzon ose bëhet agresiv, ndërprit bisedën dhe largohu.
- **Ruaj kufijtë personal:** Ngacmimi, diskriminimi, prekjat e padëshiruara dhe sjellja kërcënuese nuk tolerohen.
- **Mos fotografo të dhëna personale:** Formularët, dokumentet e identifikimit dhe të dhënat e qytetarëve nuk fotografohen apo shpërndahen.
- **Mbaje njësinë të aksesueshme:** Materialet, tavolinat dhe pajisjet nuk duhet të pengojnë kalimin.
- **Kujdes me motin dhe lodhjen:** Merr ujë, bëj pushim dhe ndërprit turnin nëse kushtet bëhen të papërshtatshme.
- **Mos u largo vetëm nëse nuk ndihesh i sigurt:** Në fund të turnit, kërko shoqërim ose ndihmë me transportin nëse të nevojitet.
- **Trego çfarë të duhet:** Nëse ke nevojë të ulesh, pushime, njofto ekipin.
- **Raporto edhe incidentet e vogla:** Një kërcënim, tentativë mashtrimi apo problem me formularët mund të jetë i rëndësishëm edhe nëse situata përfundon shpejt.

MBAJ MEND!

Nuk ke detyrim të durosh një situatë që të bën të ndihesh i/e pasigurt. Nuk ke detyrim të fitosh një debat. Dhe nuk ke pse të përballesh vetëm me një problem. Nëse diçka nuk të duket në rregull: largohu, njofto, dokumento dhe kërko ndihmë.



15

PYETJE TË SHPESHTA

Këto janë disa nga pyetjet që ka më shumë gjasa të dëgjosh në terren. Përgjigju shkurt, qartë dhe vetëm me atë që dimë me siguri. Nëse një pyetje kërkon interpretim ligjor ose informacion më të hollësishëm, mos improvizo — drejtoje qytetarin te informacioni i plotë në portal ose te ekipi përkatës.

PYEJTET E SHPESHTA	PËRGJIGJET
A do të thotë depozitimi i kërkesës se referendumi është miratuar?	Jo. Depozitimi nis procesin formal, por nuk do të thotë automatikisht se mbledhja e firmave është autorizuar ose se referendumi do të zhvillohet. Procesi kalon neper disa hapa institucionale dhe ligjore.
Sa firma duhen?	Duhet të mblidhen të paktën 50,000 nënshkrime të vlefshme nga qytetare shqiptare me të drejte vote. Në praktike synohet të mblidhen më shumë, sepse disa nënshkrime mund të mos kalojnë verifikimin. Mbaje mend: rendesi kanë 50,000 nënshkrime të vlefshme, jo thjesht 50,000 të mbledhura.
A mjaftojnë 50,000 nënshkrime që referendumi të zhvillohet?	Jo. Arritja e pragut është një hap shumë i rëndësishëm, por pas tij vijojnë verifikimet dhe fazat e tjera kushtetuese dhe institucionale të procesit.
A mund ta ndalojë Kuvendi referendumin?	Jo thjesht me një vendim politik. Nëse plotësohen kushtet kushtetuese dhe procedurale, procesi duhet të ndiqe rrugën e përcaktuar nga ligji dhe Kushtetuta.
A mund të firmosë dikush nga diaspora?	Po, nëse është qytetar shqiptar me të drejte vote dhe plotëson kërkesat që zbatohen për procesin. Menyra konkrete të nënshkrimit duhet gjithmonë të ndiqe udhëzimet zyrtare në fuqi të KQZ-se. Për informacionin më të fundit, kontrolloni seksionin Ndëqni në portal.
A nevojitet mbështetja e një partie politike?	Jo. Mbështetja e një partie politike nuk është e nevojshme për këtë nisje. Referendumi është një nisje qytetare, e pavarur dhe jopartiake, e nisur formalisht nga 12 qytetare nismetare.
Po nëse me bëjnë një pyetje për të cilën nuk jam i/e sigurt?	Mos hamendeso dhe mos improvizo. Thuaj që dëshiron ta verifikosh informacionin dhe kontrollo FAQ-ne, seksionin Verifikoni, portalin ose pyet personin përgjegjës. Është gjithmonë më mirë të thuash “do ta verifikojmë” sesa të japësh një përgjigje të pasakte.

NUK E GJETE PYETJEN?

Kontrollo portalin ose pyet koordinatoren.



16

SI PUNOJMË ME NJËRI-TJETRIN

Kjo nismë mbështetet te puna vullnetare dhe te besimi mes njerëzve që kontribuojnë në të. Prandaj, marrëdhënia jonë është e ndërsjellë dhe tryeza jonë e punës është gjithmonë e rrumbullakët.

ÇFARË PËRPIQEMI TË SIGUROJMË SË BASHKU:



Përgatitje: trajnim, materiale dhe udhëzime të qarta përpara se të marrësh përsipër një rol



Mbështetje: dikush te i cili mund të drejtohesh kur ke një pyetje, shqetësim ose problem.



Përgjigje: synojmë t'u përgjigjemi raportimeve dhe çështjeve serioze brenda 48 orësh.



Respekt: për kohën, kufijtë, privatësinë dhe mirëqenien e të gjithëve.



Qartësi: nëse diçka ndryshon në proces, do të përpiqemi të të informojmë sa më shpejt dhe sa më qartë.



Kujdes për punën: materialet, të dhënat dhe informacioni që na besohen trajtohen me përgjegjësi.



Hapësirë për të folur nëse diçka nuk funksionon, na shqetëson ose mendojmë se mund të bëhet më mirë, e themi. Të ngriturit e një shqetësimi është pjesë e kujdesit për nismën.

JEMI TË GJITHË VULLNETARË

Nga terreni te koordinimi dhe ekipet mbështetëse, të gjithë po japim kohë, energji dhe aftësi vullnetarisht.

Ndonjëherë një përgjigje mund të vonojë ose një plan mund të ndryshojë, sepse secili po përpiqet ta ndërthurë këtë angazhim me pjesën tjetër të jetës së vet. Prandaj përpiqemi të kemi durim me njëri-tjetrin, të kërkojmë ndihmë kur na duhet dhe të komunikojmë hapur kur diçka nuk po funksionon.



ASKUSH NUK DUHET T'I DIJË OSE T'I BËJË TË GJITHRA. SECILI MBAN PJESËN E VET DHE, KUR KEMI NEVOJË, MBËSHTETEMI TE NJËRI-TJETRI.

17 TË NJOHIM KONTRIBUTIN TËND

Nuk ka kontribut të vogël. Çdo turn, çdo bisedë, çdo qytetar që informon dhe çdo person që fton të përfshihet është pjesë reale e kësaj përpjekjeje të përbashkët. **Nënshkrimi i pesëmbëdhjetë i një pasditeje ka të njëjtën vlerë si i pesëqindti.** Pas çdo numri ka kohë, përkushtim dhe një njeri që ka zgjedhur të marrë pjesë. Ajo që po ndërtojmë së bashku ka rëndësi.

NDAJE UDHËTIMIN TËND

Nëse dëshiron, dokumentoje përvojën tënde. Ndaj një moment nga turni, një reflektim, një arritje apo diçka që të ka bërë përshtypje. Fotografitë mund të publikohen vetëm me pëlqimin e personave që shfaqen në to dhe pa ekspozuar formularë, nënshkrime apo të dhëna personale.

Mund ta ndash përvojën në portal, në grupin e ekipit ose me njerëzit e tu. Duam të dëgjojmë jo vetëm sukseset, por edhe pyetjet, vështirësitë dhe gjërat që mund t'i bëjmë më mirë së bashku.

Je pjesë e një komuniteti njerëzish që po japin kohën, dijen dhe energjinë e tyre për një qëllim publik. Ke çdo arsye të jesh krenar/e për pjesën tënde.

SHTOJCAT

A · Pse duhet referendum

Why a referendum

Ky është përmbledhja. Analiza e plotë — 27 faqe, me çdo citim ligjor, numër VKM-je dhe paragraf rezolute — është dokument më vete (“Pse duhet referendum, v2”), i disponueshëm në portal dhe te faja “Kupto” e faqes sonë.

This is the summary. The full analysis — 27 pages, with every legal citation, VKM number and resolution paragraph — is a separate document (“Why a referendum, v2”), available on the portal and the “Understand” page of our website.

ARSYEJA 1 Njëperson, dy institucione, i gjithë zinxhiri

One person, two institutions, the whole chain

Ligji 21/2024 ndau vendimin për ndërtimin në zonat e mbrojtura në dy hapa — çfarë lejohet (Këshilli i Ministrave) dhe kush ndërton (Këshilli Kombëtar i Territorit) — por të dy organet kryesohen nga Kryeministri. E njëjta ditë, 25 shtator 2024, dhjetë zona u rishpallën me kategori mbrojtjeje më të ulët ndërsa një zhvillues paraqiste kërkesën e tij për Zvërnec.

Law 21/2024 split the decision on construction in protected areas into two steps — what's allowed (Council of Ministers) and who builds (National Territory Council) — but both bodies are chaired by the Prime Minister. On the same day, 25 September 2024, ten areas were reclassified to a lower protection category while a developer filed its request for Zvërnec.

ARSYEJA 2 Bashkimi Evropian kërkon shfuqizimin, si kusht anëtarësimi

The EU demands repeal, as a membership condition

Parlamenti Evropian ka kërkuar shfuqizimin dy herë radhazi (korrik 2025, qershor 2026). Komisionerja Marta Kos konfirmoi më 14 korrik 2026 se shfuqizimi ishte rënë dakord me qeverinë shqiptare para se të nisnin protestat. Qeveria është përgjigjur me “përshtatje”, jo shfuqizim.

The European Parliament has demanded repeal twice in a row (July 2025, June 2026). Commissioner Marta Kos confirmed on 14 July 2026 that repeal had been agreed with the Albanian government before the protests even began. The government has responded with “adjustment”, not repeal.

ARSYEJA 3 Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis nuk funksionon si filtër

Environmental Impact Assessment doesn't work as a filter

Nga 212 kompani me leje në zona të mbrojtura, vetëm 7 kanë VNM të publikuar, dhe vetëm 1 për projektin e miratuar. Studimi i vetëm sistematik i VNM-ve në Shqipëri gjen se lista e specieve mungon në 85.5% të raporteve.

Of 212 companies licensed in protected areas, only 7 have a published EIA, and only 1 for the actual approved project. The only systematic study of EIAs in Albania found the species list missing in 85.5% of reports.

ARSYEJA 4 Bashkëmeligjine investimeve strategjike: tokë publike te privati

Alongside the strategic investments law: public land to private hands

Ligji 21/2024, i lexuar bashkë me Ligjin 55/2015, plotëson mekanizmin: shteti mund t'i japë tokën e vet publike një investitori privat, edhe brenda një zone të mbrojtur. Deri tani, rreth 5.8 milionë m² tokë publike u janë dhënë investitorëve strategjikë.

Burimet e plota për këto katër arsye — përfshirë çdo rezolutë, vendim gjykatë dhe VKM — janë në dokumentin e plotë dhe në Shtojcën D.

Law 21/2024, read together with Law 55/2015, completes the mechanism: the state can hand its own public land to a private investor, even inside a protected area. To date, roughly 5.8 million m² of public land has gone to strategic investors.

B · Bëj / Mos bëj *Do's and don'ts*

BËJ · DO	MOS BËJ · DON'T
✓ Kërko gjithmonë të shohësh autorizimin e mbledhësit.	× Mos lejo nënshkrim pa letërnjoftim ose pasaportë të vlefshme.
✓ Numëro fletët me kujdes në fund të çdo turni.	× Mos e foto grafo asnjëherë një formular të nënshkruar.
✓ Drejto pyetjet e ndërlikuara te koordinatori ose Juristi.	× Mos jep interpretime ligjore vetë, edhe nëse mendon se e di përgjigjen.
✓ Mbaje qetësinë kur dikush kundërshton.	× Mos u përfshi në debat apo konflikt publik.
✓ Raportoçdoshqetësim — edhe të vogël—samë shpejt.	× Mos e mbaj një problem për vete,duke shpresuar se zgjidhetvetë.
✓ Përfaqësonismënme krenari dhe dinjitet.	× Mos premtorezultateapodataspecifike që s'i di me siguri.

C · Politikat e plota & Fjalorth *Full policies*

Ky doracakpërmbledh parimetkryesore.

Politikat e plota,zyrtare, janëdokumentemë vete — të disponueshme nëportal:

- Standardet e Komunitetit (UDACN Community Standards)
- Politika e Komunikimit dhe Mediave Sociale
- Formulari i Pëlqimit për Publikim dhe Media Sociale
- Struktura dhe Rolet (dokumenti i plotë, 39 faqe)
- Njoftimi i Privatësisë (për vullnetarë dhe nënshkrues)

Fjalorth i shkurtër · Shortglossary

This handbook summarises the core principles. The full, official policies are separated documents—available on the portal:

- UDACN Community Standards*
- Communications & Social Media Policy*
- Publication & Social Media Consent Form*
- Structure and Roles (the full 39-page document)*
- Privacy Notice (for volunteers and signatories)*

KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve · The Central Election Commission
Grup Nismëtar	12 qytetarët aplikues zyrtarë · The 12 citizens who are the formal applicants
Njësi / Zonë	Ekipi i terrenit me kod (p.sh. A1) · The field team with a code (e.g. A1)
Turn	Blok kohe i planifikuar për mbledhje · A planned block of time for collection
Check-in / Check-out	Fillimi dhe mbyllja e turnit në portal · Opening and closing a shift on the portal
Autorizim me shkrim	Dokumenti që bën një mbledhës të ligjshëm · The document that makes a collector lawful

D · Burimet

Sources

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Nenet 2, 56, 100, 150–152) · Ligji Nr. 21/2024 · Ligji Nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” · Ligji Nr. 55/2015 “Për investimet strategjike” · Vendimi Nr. 45/2025 i Gjykatës Kushtetuese (31 korrik 2025) · Rezolutat e Parlamentit Evropian P10_TA(2025)0155 dhe P10_TA(2026)0217 · Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2025, SWD(2025)0750 · Nezaj, M. (2022), Albanian Journal of Agricultural Sciences.

Constitution of the Republic of Albania (Articles 2, 56, 100, 150–152) · Law No. 21/2024 · Law No. 81/2017 “On Protected Areas” · Law No. 55/2015 “On Strategic Investments” · Constitutional Court Decision No. 45/2025 (31 July 2025) · European Parliament resolutions P10_TA(2025)0155 and P10_TA(2026)0217 · European Commission 2025 Report on Albania, SWD(2025)0750 · Nezaj, M. (2022), Albanian Journal of Agricultural Sciences.

Listaeplotëeburimevedhemetodologjia:ShtojcaAdheBe dokumentit “Pse duhet referendum, v2”.

— Fund i Doracakut · End of Handbook —
“Natyra nuk shitet, mbrohet, trashëgohet.”